33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

#### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin e impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme të Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

#### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

### **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

#### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimi;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigojë brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta lirojë vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në ~~çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj~~ e shkakuar jo me fajin apo neglizhinin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39**                    **Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40**                    **Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41**                    **Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42**                    **Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43**                    **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-21-695-5-2-1/C709

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	<p>Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>38.760,00 EUR</b>.</p> <p>Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>38.760,00 EUR</b> nga vlera e kësaj kontrate me garancion bankar nga një bankë e licencuar ose kompani sigurimesh e licencuar nga BQ e Kosovës, për një periudhë garantuese prej së paku <b>210 ditëve</b>, duke filluar nga data e fillimit të punimeve.</p> <p>- Pas përfundimit të punimeve dhe pranimit të tyre nga Komisioni i Autorizuar, Kontraktuesi duhet të depozitojë Sigurimin e përmbushjes në vlerën 10% nga vlera e punimeve të realizuara si garancë për kualitetin dhe cilësinë e punëve në afatin prej 12 muaj nga data e pranimit të punimeve nga Organi kompetent</p>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>(ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <b>15 ditë</b> kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.

	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <b>15 ditë</b> kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <b>15 dite</b> pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë <b>180 ditë</b> kalendarike.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.25%</b> e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10%</b> e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	<b>Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,</b>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës
Parimet përgjithshme të pagesave	24	Autoriteti Kontraktues do të paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione në vlera minimale nga <b>30.000,00 €</b> me tepër € për punët e kryera dhe të konstatuara nga menaxheri i kontratës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <b>nuk ka pagese paraprake</b>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <b>10% i vlerës së kontratës.</b>  Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda <b>30 ditësh</b> nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK.  Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë të mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”.  <b>Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve në afat prej 12 muajve.</b>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <b>15 ditë</b> kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuere e defekteve është <b>365 ditë</b> e cila mbulohet në formë të sigurimit të ekzekutimit sipas pikës 10.1
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <b>përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.</b>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<b>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në pajtim me ligjin në Kosovë.  ose



		<p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <b>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</b></p> <p><b>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</b></p>
--	--	---

Prokurimi: 616-21-695-5-2-1

Nr i brendshëm: 616 21 022 521

**Titulli:** Ndertimi i aneksit te shkolles Pavaresia

**I** Ndertimi i aneksit te shkolles Pavaresia

**Kodi i tenderit:** 045T/2021

**Data:** 06.08.2021

**Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse**

---

Nr.	Dokument
1.	0 Përmbajtja e Tenderit.pdf
2.	1 Aneks 1 & 2 & 3.pdf
3.	2 Qertifikata biznesit TVSH.pdf
4.	2.1 Qertifikata biz, tvsh.pdf
5.	3 Qarkullimi Bankar.pdf
6.	4 Lista e projekteve, Referencave.pdf
7.	4.1 Lista projektev - Referencat.pdf
8.	5 Lista e Stafit.pdf
9.	5.1 Lista e stafit.pdf
10.	5.2 Lista e stafit.pdf
11.	6 Isot - Copy.pdf
12.	7 Makineria me LG.pdf
13.	7.1 Makineria me LG.pdf
14.	8 Qarkullimi me ATK.pdf
15.	9 Marrveshjet, Vendimi Menaxh., Plani Dinamik.pdf
16.	10 Sigurimi i Tenderit.pdf

**Përshkrimi i çmimeve**

---

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Ndertimi i aneksit te shkolles Pavaresia	PARAMASA - PR. 06.08.2021.pdf

**Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:**

---

nuk ka

## **AUTORITETI KONTRAKTUES**

---

**KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2, -, PRISHTINË,**

**Zyrtari përgjegjes i prokurimit:**

**Nr i Prokurimit: 616-21-695-5-2-1**

### **OPERATOR EKONOMIK:**

---

**Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Grup i Operatorëve Ekonomik TRIANGLE SH.P.K.; INTACT SH.P.K.,  
rr.Brigada123, 23000, Suharekë, Kosovë**

**E-mail: triangle.shpk@gmail.com**

**Personi kontaktues: Ukë Baftjaraj**

**Telefoni: 049 473 653**

**Faxi:**

**Numri fiskal:**

**Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):**

**Partneri 1.**

**Emri i kompanisë: "TRIANGLE" SH.P.K.**

**Numri fiskal: 810048167**

**Vend-Selia rr.Brigada123, 23000, Suharekë, Kosovë**

**Partneri 2.**

**Emri i kompanisë: INTACT SH.P.K.**

**Numri fiskal: 811321322**

**Vend-Selia: rr.Saraçevë pn., 20000, Prizren, Kosovë**

# FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

## Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-21-695-5-2-1

Titulli i kontratës: Ndertimi i aneksit te shkolles Pavaresia

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

### 1 Ndertimi i aneksit te shkolles Pavaresia

3. Çmimi total i tenderit është:

387 600,45 EUR

Dhe në fjalë *[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]*

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK
8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

nash nëse e bën këtë.

**Informacion në lidhje me nënkontraktorët**

Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

ANEKSI I SHFMU „PAVARËSIA”

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

*Kushte të përgjithshme:*

*Përshkrimi i punëve. Në përpuethshmëri të plotë me standardet EC dhe ISO.*

*Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këte mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtes dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtes.*

*Punishtja të rrethohet me tabela prej llamarine dhe me konstruksion të përforcuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheli edhe çkyqjen e instalimeve ekzistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikyqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin të instalimeve ekzistuese te cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.*

*Për çdo ndryshim të mundshëm në projekt gjatë realizimit të punimeve duhet të konsultohet organi mbikëqyrës dhe projektantin.*

*Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakterisika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO.*

*Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vuarjen në vepër të materialeve për secilin pozicion*

PUNET ARKITEKTONIKE DHE NDERTIMORE

**Vërejtje:** Pozicionet në paramasë përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin e materialeve , fuqinë punëtofe, testimet e nevojshme , mekanizimin dhe puniminin e pozicionit me të gjitha aktivitetet dhe materialet. Gjithashtu cdo demtim i bere nga punekryesi ne infrastrukturen egzistuese (gypa te ujesjellesit , kanalizimit , instalimeve elektrike dhe të tjera ), punekrueresi eshte i obliguar ta riparoj

	PËRSHKRIMI I POZICIONEVE	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
1	<b>PUNËT PËRGADITORE</b>				
1.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Furnizimi me material per vedosjen e tabelës ne dy vende me emrat e investitorit, ndermarrjes projektuese dhe ndermarrjes ndertuese, vleres investuese dhe fillimin dhe mbarimin e projektit. Tabela duhet te punohet nga materialet e kualitetit te larte dhe me shlyp te kualitetit te mire per dukje te qarte nga distanca e larget. Te gjitha duhet te punohen me udhezime nga mbikqyresi i punimeve.	cope	2.00	150.00	300.00
1.2	Rrethimi i komplet punishtes ne perimetrin e saj ne menyre qe mos te kete qasje nga kalimtare e rasilit. Rrethimi të bëhet nga matereiali perkatese per kete lloj pune d.m.th nga materialet perkatese dhe i cili lejon zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sipas kërkesave te investitorit.	m'	250.00	5.00	1,250.00



1.3	<p>Ndërtimi i punishtës që përfshinë:</p> <p>a) Zyra e përkohshme e ndërmarrjes më së paku 2 ndarje, secila ndarje duhet të ketë së paku sipërfaqe S=12m<sup>2</sup>, me nyje sanitare si dhe e kyçur në furnizimin me energji të pandërprerë elektrike dhe të ujit. Zyra duhet të ketë lidhje në kanalizimin publik funksional ose në një rezervuar ekologjik mobil.</p> <p>b) Zyra për organin mbikqyrës (minimum S=16m<sup>2</sup>), një tavolinë pune me minimum 6 karriga pune për gjatë gjithë kohës së ndërtimit</p> <p>c) WC ekologjike mobile për stafin punues ekzekutiv për gjatë gjithë kohës së ndërtimit</p> <p>d) Furnizimi i zyrës me lidhje për komunikim: telefon, faks dhe internet për gjatë gjithë kohës së ndërtimit.</p>	cope	1.00	500.00	500.00
1.4	<p>Kontrollimi dhe evdntimi i instalimeve nëntoksore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesit të ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e furnizimit të objekteve institucionale të prekura nga ndërtimi më të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të ujrave fekale si dhe më telefoni. Për të gjitha këto shërbime, kontaktori duhet të ofroj plan detal të furnizimit të përkohshëm të objekteve dhe për të gjitha hargjimet mban përgjegjesin kontraktuse, dmt. investitori nuk merr mbi vete kosto shtesë përveç çmimit që kontraktori oferton në kete pozicion, investitori ka të drejtën e ndërmarrjes së hapave që te furnizoi vet institucionet publike dhe lokalet afariste përmes kontraktimit të një kontraktori tjetër, përmes një kontratë emergjente (një person tjetër juridik) dhe tërë koston do ta mbaj kontraktori i ketij pozicioni.</p>	m <sup>2</sup>	1,500.00	1.00	1,500.00
1.5	<p>Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperve te rrjetes shietrore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do te kaloj rrjeti hidroteknik: ujsjellësi, kanalizimi fekal dhe kanalizimi atmosferik.</p>	m <sup>2</sup>	1,500.00	0.50	750.00
1.6	<p>Shënjestërimi i instalimeve nëntoksore te cilat nuk çvendosen nga pozicioni ekzistues.</p>	m <sup>2</sup>	1,500.00	0.20	300.00
1.7	<p>Sigurimi i punishtes nga hyrjet anesore te automjeteve. Sigurimi të bëhet përmes shenjave përkatëse te cilat krijojn siguri dhe zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sipas kërkesave te investitorit.</p>	m <sup>2</sup>	1,500.00	0.20	300.00



1.8	Egzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjës në vepër të tyre si psh. tamponit , gurit te graniitit dhe elementeve tjera te cilat planifikohen per shqyrtim ne keke projekt. <b>Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake lidhur me origjinen e materialit para fillimit të punimeve sipas te gjithave specifikave dhe pamjeve nga materiali i dorezuar edhe ate te shenuara nga pozicionet e veqanta ne baze te emerimit te produkteve.Te gjitha produktet jane me origjine nga shtetet anetare te EU dhe ne asnje menyre nga shtetet tjera.Per te gjitha keto do te keke perkujdesje te veqante nga projektanti dhe ekipi mbikqyres.</b>	p.s.	1.00	300.00	300.00
<b>Shuma 1</b>					<b>5,200.00</b>

<b>2 PUNËT E DEMOLIMEVE DHE ÇVENDOSJEVE</b>					
2.1	Demolimi i konstruksionit beton ame,mureve,konstruksionit te fasades ,dritareve dhe materialeve tjera qe janë te pjesa e hapësires per shume qellime. Materiali i grumbulluar duhet të largohet në deponin e lagalizuar max 20 km sipas udhëzimeve te organit mbikqyrës.	m <sup>2</sup>	250.00	1.00	250.00
2.2	Demolimi i konstruksionit beton te pullazit (komplet me te gjitha materialet ) dhe materialeve tjera qe janë te pjesa e kulmit e hapësires per shume qellime. Materiali i grumbulluar duhet të largohet në deponin e lagalizuar max 20 km sipas udhëzimeve te organit mbikqyrës.	m <sup>2</sup>	175.00	1.00	175.00
2.3	Demolimi i tribunave (shkallëve) prej betoni, tri shkallë me dimensione 0.8X0.4X40 m dhe largimi deri në deponi te caktuar nga organi mbikqyrës.	cope	1.00	200.00	200.00
2.4	Demolimi i fushës se futbollit dhe basketbollit me dimensione (40X20) m', shtresa prej asfaltit dhe shtresave tjera deri në pjesën e dheut, dhe largimi deri në deponi te caktuar nga organi mbikqyrës.	m <sup>2</sup>	800.00	1.00	800.00
2.5	Demolimi i rrethojes prej metali në fushën e futbollit dhe basketbollit me dimensione (4X128) m'	m <sup>2</sup>	512.00	2.00	1,024.00
2.6	Zhvendosja e trafos elektrike ne largësi mesatare deri 30 m'	cope	1.00	500.00	500.00
2.7	Zhvendosja e agregatit ne largësi mesatare deri 30 m' dhe funksionalizimi i tij.	cope	1.00	100.00	100.00
<b>Shuma 2</b>					<b>3,049.00</b>

<b>3 PUNËT NDËRTIMORE</b>					
3.1	Eskavimi dhe deponimi, prapakhimi, planifikimi dhe kompaktesimi i shtreses humusore d=30cm. Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në deponi në përpulje me normativat ndërtimore	m <sup>2</sup>	765.00	2.00	1,530.00





3.2	Gërmimi i humusit dhe dheut të kategorisë së III-IV , sipas të dhënave në elaboratin gjeomekanik ,me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min 20 km.	m <sup>3</sup>	3101.70	2.00	6,203.40
3.3	Planifikimi dhe nivelizimi i nënbazës në pjesën e germuar sipas të dhënave në projekt si dhe ngjeshja e saj me cilindër deri në masë të kërkuar sipas normave dhe standardeve për këtë lloj pune (Mv = 60 MPa )	m <sup>2</sup>	765.00	1.00	765.00
3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së materialit BENTOFIX mbi shtresë e dheut të ngjeshur i cili duhet të përmbushë të gjitha kërkesat teknike sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj materiali.	m <sup>2</sup>	765.00	1.50	1,147.50
3.5	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e rërës 0-8mm për mbrojtjen e BENTOFIX me trashësi prej (5-7) cm duke paraparë edhe nivelizimin për shtresat në vazhdim	m <sup>3</sup>	55.00	6.00	330.00
3.6	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gurit të thyer, fraksion 0-150 mm, për mbushjen e pjesës nën themelin pllakë më trashësi d=40 cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 12 t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (Mv=70 MPa). Ngjeshja duhet të bëhet në shtresë 25 cm.	m <sup>3</sup>	585.00	6.50	3,802.50
3.7	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme të zhavorit të pjesa e rruges dhe pjesa e lodrave për femijë (mbrojtja kundër ngricave), fraksion 63,0 mm në më shtresë më trashësi min d=30cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 12t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (M <sub>t</sub> ≥800 kg/cm <sup>2</sup> ).	m <sup>3</sup>	375.00	7.00	2,625.00
3.8	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme të pjesa e rruges dhe pllakosjes - fraksion 0-31,5 mm me trashësi të shtresës min d=15cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (M <sub>t</sub> ≥1000 kg/cm <sup>2</sup> ).	m <sup>3</sup>	250.00	8.00	2,000.00
3.9	Furnizimi dhe mbushja me zhavor lumi (drenazha), fraksion 32/64mm, e hapësirës përreth objektit sipas specifikacionit në projekt.	m <sup>3</sup>	200.00	9.00	1,800.00
3.10	Furnizimi me zhavor nga gurthyesi d=0.1 & 0.2mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktësim.	m <sup>3</sup>	125.00	9.00	1,125.00
<b>Shuma 3</b>					<b>21,328.40</b>
<b>4</b>	<b>PUNËT E BETONIT</b>				
4.1	Furnizimi transporti dhe punimi i betonit të varfër C15/16 me trashësi t= 5 cm , si shtresë mbrojtëse e armatures ,izolimifit për të gjitha pjesët ku punohet me beton sipas të dhënave në projekt .	m <sup>3</sup>	75.00	60.00	4,500.00 €



4.2	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themel pllakës sipas detaleve dhe prerjeve ne projekt me lartësi h=40cm ( kota - 390/±330), me klasë të betonit C-25/30, betoni behet me aditiv,plastifikator në mënyr që të jetë i papershkueshem nga uji - lagështia.	m <sup>3</sup>	205.00	60.00	12,300.00 €
4.3	Furnizimi,transporti dhe betonimi i themel pllakës sipas detaleve dhe prerjeve ne projekt me lartësi h=40cm ( kota - 40/±0.00), me klasë të betonit C-25/30, betoni behet me aditiv,plastifikator në mënyr që të jetë i papershkueshem nga uji - lagështia.	m <sup>3</sup>	168.00	60.00	10,080.00 €
4.4	Furnizimi,transporti dhe betonimi i mureve ne permieter ,mureve te kethina e shkalleve dhe ashensorit dhe munerve tjera me klasë të betonit C-25/30, Betoni duhet të jetë i papershkueshem nga uji dmth duhet te jete me aditive .	m <sup>3</sup>	155.00	60.00	9,300.00 €
4.5	Furnizimi,transporti dhe betonimi i pllakave me h=20 cm per të gjitha nivelet me beton të klasit C25/30.	m <sup>3</sup>	533.50	60.00	32,010.00 €
4.6	Furnizimi transporti dhe betonimi i shtyllave dhe trajeve me beton C 30 /37 sipas të dhënave në projekt.	m <sup>3</sup>	93.50	60.00	5,610.00 €
4.7	Furnizimi transporti , betonimi i shkalleve me beton të klasit C 25 / 30 për të gjitha nivelet sipas të dhënave në projekt	m <sup>3</sup>	25.00	60.00	1,500.00 €
4.8	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm , kallupimi dhe betonimi i Trajeve mbi Dyer & Dritare h=20 cm nga Betoni i Armuar C-25/30 sipas Projektit Kryesorë dhe Përshkrimit Teknik .Llogarimi ne m <sup>3</sup> te betonit te vendosur.	m <sup>3</sup>	15.00	60.00	900.00 €
<b>Shuma 4</b>					<b>76,200.00</b>
<b>5 PUNËT ARMATURES</b>					
5.1	Furnizimi,prerja,lakimi dhe vendosja e armatures per te gjitha pozicionet ne projekt .	kg	118,000.00	0.55	64,900.00 €
<b>Shuma 5</b>					<b>64,900.00</b>
<b>6 PUNËT E HIDROIZOLIMIT</b>					
6.1	Furnizimi dhe vendosja e hidroizolimit nga kondori i zallosur ne dy shtresat (4+5)mm në dyshemet dhe muret e Suteranit	m <sup>2</sup>	590.00	4.00	2,360.00 €
6.3	Furnizimi dhe vendosja e materialit hidroizolues BENTOFIX mbi shtresen e Zhavorit	m <sup>2</sup>	550.00	1.00	550.00 €
6.4	Furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit me kondor l=(4+5)mm në muri në perimeter në suteran. Kondori duhet te jete me karakteristika sipas normave EN.	m <sup>2</sup>	275.00	4.00	1,100.00 €
6.5	Furnizimi dhe vendosja e mbrojtjes se hidroizolimit -Tefold .Dy shtresa stirodure me l=(3+3) cm.	m <sup>2</sup>	275.00	4.00	1,100.00 €



				Shuma 6	5,110.00
--	--	--	--	---------	----------

7	PUNËT E MURATIMIT				
---	-------------------	--	--	--	--

